

Z. Din Shiqerukaj

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 2956 prot., datë 27.04.2022, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ju sqarojmë se:

Në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë, ju ka caktuar pension pleqërie me VCP nr. 268, datë 17.07.1996, me vjetërsi pune 35 vite e 4 muaj, masë pensioni 2,710 lekë dhe datë fillimi pensioni 31.12.1995.

Dega e Sigurimeve Shoqërore Tropojë ka llogaritur saktë masën e pensionit, duke u bazuar në dokumentacionin që ju keni dorëzuar në momentin që keni dalë në pension, në përputhje të plotë me Ligjin për sigurimet shoqërore.

Pensioni juaj nuk ka qenë objekt i rillogaritjes me Ligjin 9588, datë 25.07.2006, mbi llogaritjen e pensioneve të pleqërisë me pagë referuese, pasi sipas nenit 3, të këtij Ligji, është përcaktuar se: *"rillogaritja e pensionit bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit"*.

Pensioni juaj nuk ka qenë objekt rishqyrtimi sipas VKM nr. 409, datë 01.06.2016 "Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve", të ndryshuar, sepse masa fillestare e pensionit tuaj është 2,710 lekë në muaj. Objekt përfitimi sipas kësaj VKM-je janë vetëm pensionet e plota të pleqërisë, të caktuara në periudhën 01.10.1995 deri në 31.03.1996, me masë pensioni 3,070 lekë – 5,420 lekë në muaj.

Në masën e pensionit që ju përfitoni, janë zbatuar të gjitha indeksimet të përcaktuara me VKM dhe aktualisht masa e pensionit të pleqërisë është 14,930 lekë në muaj.

Faleminderit për mirëkuptimin.

